

parallogaritjeve të sindikatës, punëtorët arsimorë mbajnë mbi 300 orë mbi parashikimin me kontrata pune dhe ata nuk marrin asnjë kompensim për to. "Për të vendosur rend që punëtorët arsimorë të angazhohen në punë vetëm me normë e paraparë me kontrata, Komuna e Vitisë duhet të angazhojë së paku edhe 15 punëtorë arsimorë, por as kjo gjë nuk është arritur. Prandaj në shumicën e shkollave arsimtarët mbajnë orët mbi normën e paraparë me kontrata", ka thënë Abazi.

Edhe Zyra rajonale e Inspektoratit të Arsimit, problem in e angazhimit të punëtorëve arsimorë mbi normën e paraparë me kontratë e sheh si një problem për zgjidhjen e të cilit duhet angazhim më i madh i Komunës.

Riza Fazliu, udhëheqës i Zyrës së Inspektoratit, ka thënë se Komuna gjatë planifikimit të buxhetit duhet të gjejë zgjidhje për problemin e

Murat Abazi, kryetar i SBASHK-ut për Vitinë, ka thënë se sipas disa parallogaritjeve të sindikatës, punëtorët arsimorë mbajnë mbi 300 orë mbi parashikimin me kontrata pune dhe ata nuk marrin asnjë kompensim për to

angazhimit të arsimtarëve mbi normën. "Inspektorati gjatë inspektimeve në terren ka vërejtur se punëtorët arsimorë në Komunën e Vitisë ballafaqohet me problemin e angazhimit mbi normë dhe kjo çështje duhet të zgjidhet nga Komuna dhe institucionet qendrore, pasi ose duhet të angazhohen punëtorët e rinj, ose norma e këtyre punëtorëve duhet t'u kompensohet", ka thënë Fazliu.

Por sipas zyrtarëve komunalë të Vitisë, formula e angazhimit të punëtorëve arsimorë është formula më e mirë e mundshme për funksionimin e të gjitha shkollave pavarësisht numrit të nxënësve që

kanë. "Buxheti për arsimin jepet për kokë të nxënësve dhe pasi shumë shkolla kanë numër të vogël nxënësish, jemi të detyruar që të përdorim këtë formulë që është më e përshtatshme për funksionimin e të gjitha shkollave", ka thënë Islam Jashari, drejtor komunal i Ekonomisë. Ai ka mohuar të jenë 300 orë shtesë në javë në të cilat janë të angazhuar arsimtarët me kontrata pune dhe ka thënë se Komuna në vazhdimësi ka pasur kontakte me sindikatën dhe ka sqaruar këtë problem. "Buxheti për arsimin është i kufizuar dhe Komuna s'ka mundësi që punëtorët arsimorë të angazhohen mbi normën t'i kompensojë", ka thënë Jashari.

Kuvendi i debaton taksat e tarifat pa diskutim publik

Autoritetet komunale në Lipjan janë të sigurt se rregullorja e cekur nuk ka pasur nevojë të dalë në diskutim publik

Arian Duriqi

LIPJAN, 29 JANAR - Propozimi i Rregullores për taksat e tarifat komunale do të dalë para kuvendarëve të Lipjanit të mërkurën, pa e organizuar asnjë debat publik lidhur me këtë çështje, edhe pse kjo sipas shoqërisë civile në këtë komunë ka të bëjë me interesin publik. Dhe kjo ka bërë që shoqëria civile në Lipjan, përkatësisht Organizata joqeveritare e të rinjve, YAHR, ta quajë veprimin joligjor, edhe pse nga ana tjetër autoritetet komunale pretendojnë se ky propozim nuk e ka pasur nevojën e diskutimit publik për shkak se rregullorja nuk është e re, por që do të modifikohet në disa pika. Mirëpo Bekim Krasniqi, udhëheqës në YAHR, këmbëngul se rregulloret e tilla nuk duhet të propozohen për shqyrtim në KK para debatit publik.

"Organizata joqeveritare YAHR reagon ndaj shkeljeve ligjore që janë bërë nga Komuna e Lipjanit me rastin e mosdaljes për shqyrtim publik të propozim - rregullores për taksat dhe tarifa komunale. Komuna e Lipjanit nuk e ka organizuar asnjë debat publik me qytetarët e saj, në kohën kur rregulloret e tilla kanë të bëjnë me interesin publik", ka thënë ai. Propozim-rregullorja për taksat e tarifat ndërkaq ka shkuar drejtpërsëdrejti te kuvendarët për miratim për seancën e 35-të e cila do të mbahet të mërkurën, më 30 janar.



Organizata joqeveritare YAHR ka reaguar ndaj shkeljeve ligjore që janë bërë nga Komuna e Lipjanit me rastin e mosdaljes për shqyrtim publik të propozim-rregullores për taksat dhe tarifa komunale

Por, shoqëria civile bën thirrje drejt këshilltarëve që mos ta votojnë propozimin në fjalë.

"Kërkojmë nga kuvendarët që mos ta miratojnë këto projekt-rregullore dhe që t'i kthehen prapë propozuesit për respektimin e proceseve ligjore, sepse Udhëzimi Administrativ 2008/9 për transparencën në komuna të MAPL-së e kërkon nevojën e diskutimit publik. Neni 7.1 thotë: Aktet normative të Kuvendit të Komunës ose organeve të tjera komunale, përfshirë rregulloret dhe vendimet, i nënshtrohen diskutimit publik para miratimit", ka thënë Krasniqi.

Mirëpo autoritetet komunale në Lipjan, pavarësisht asaj që ka ngritur shoqëria civile, shprehen të sigurt se rregullorja në fjalë nuk ka pasur nevojë të dalë në diskutim publik për disa arsye që, sipas tyre, nuk dëmtojnë ligjin.

"Kjo nuk është rregullore e re, por që i janë ndërruar disa pika dhe për këtë arsye s'ka pasur nevojë të dalë në diskutim publik, sepse të gjitha pikat shtesë të saj janë harmonizuar me rregulloren që ishte më herët", ka thënë Hasan Luma, shef në Zyrën e informacionit publik në Lipjan.

Kthim
pa n

GJAKOVË, 29 JANAR
si dhe atyre nga raju
Armend Behluli, sh
dosjes ende ekziston
që nuk janë kthyer r
"Vetëm kohët e fur
hur dëshirën për t'u
nuk kanë prona. Vle
kthyer vetëm një far
i është ndërtuar shtë
Ky ishte edhe rasti
gjatë vitit 20012, ndë
për Kthim e Komuni
"Por Ministria... n
arsyetuar se nuk kis
Ndërsa duke u nd
Perëndimit, Behluli t
me vitet e kaluara. P
"Riadthesimi nga
marrë vëmendjen e
alokuar edhe buxhe
mbetet proces i vësh

Repartit i he

GJILAN, 29 JANAR- A
është i stërmbushur
taria, ngase atë e gra
soneli i Spitalit të Gji
Afrim Bekteshi, she
ton aktualisht ka 60 j
e hemodializës, duka
repartit të ngarkohet
mjekësore. "Po të is
kishim pse të anko
sallë në dispozicion
trajtohen rreth 60 pac
Kaçaniku që janë 14
t'u krijohen kushte m
ka kapacitete ta përb
isht 14 pacientë që b
mirë që të transferoh
ka shtuar ai. Sipas
hapësira. Ai ka theks
patit C, për çfarë i ka
detit Publik në Pris
ndodhë dhe besoj se g
shpejt edhe t' i marri

LDK-ja

GJILAN, 29 JANAR- L
kërkuar nga Riad Ra
për Zhvillim Ekonom
ka thënë se pas publi
"Ne si LDK kemi in
zotëria në fjalë shpes
Rashiti është në konfl
tor për zhvillim ekon
sigurimesh me seli në
tist të jepen sqarime
kohës së ushtrimit të